



VENDIM

Nr. 59 Datë 22.06.2011

PËR

**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “HIDROPOWER ELEKTRIK” SH.P.K
NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve; 8 pika 2 gërma “a”, 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5 pika 1 gërma “a”, 12, 13, 14 pika 1 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.06.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “HIDROPOWER ELEKTRIK” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “SLLABINJE 2A” me fuqi 2 MW, “SLLABINJE 2B” me fuqi 1.6 MW, “SLLABINJE 2C me fuqi 1.8 MW”, “SLLABINJE 2D me fuqi 5 MW” dhe “SLLABINJE 2E me fuqi 3.4 MW, për një periudhë 30 vjeçare”.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-s
NE DETYRE
Entela SHEHAJ